


Raport per

# MONITORIMIN E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR

Gusht – Dhjetor 2023



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



Instituti për të drejtat e njeriut

Titulli:

**RAPORT PËR MONITORIMIN E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR TË REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË SË VERIUT  
Gusht – Dhjetor 2023**

Botues:

Shoqata e qytetarëve Instituti për të drejtat e njeriut Shkup

Skopje, Dhjetor 2023

---

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.  
Përmbajtja e tij në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropia.

# PËRMBAJTJE

---

<b>HYRJE</b> .....	<b>4</b>
<b>TRANSPARENCA E KËSHILLIT GJYQËSOR</b> .....	<b>4</b>
Votimi dhe sistemi i regjistrimit audio .....	5
Seancat publike të KGjRMV-së.....	5
Raportet vjetore mbi punën e KGjRMV-së .....	6
Analizë e përmbajtjes së publikimeve dhe deklaratave për media të Këshillit Gjyqësor .....	7
Transparenca ndaj publikut dhe mediave .....	7
<b>EFEKTIVITETI DHE EFIKASITETI I KËSHILLIT GJYQËSOR</b> .....	<b>8</b>
Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve .....	8
Zgjedhja e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave .....	8
Shkarkimi i gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave.....	11
Monitorimi i punës së gjykatave.....	12
Vendimmarrja lidhur me parashtresat e qytetarëve dhe personave juridikë .....	12
<b>KONKLUZIONE</b> .....	<b>14</b>
<b>REKOMANDIME</b> .....	<b>16</b>

# HYRJE


---



Gusht – Dhjetor  
2023

Instituti për të Drejtat e Njeriut, nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha seancat e hapura, rregullisht monitoron punën e Këshillit Gjyqësor. Qëllimi i këtij aktiviteti është që, duke monitoruar objektivisht punën e Këshillit Gjyqësor, Instituti për të Drejtat e Njeriut të evidentojë sfidat dhe progresin në punën e tij, si dhe të kontribuojë, me konkluzione dhe rekomandime të bazuara në prova, në përmirësimin e situatës në gjyqësor. Ky aktivitet realizohet në kuadër të programit “Qasje në drejtësi për të gjithë”, financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit IPA III për shoqërinë civile dhe mediat 2021.

Ky raport është i ndarë në tri pjesë kryesore të cilat lidhen respektivisht me **transparencën**, **efektivitetin** dhe **efikasitetin e Këshillit Gjyqësor**.



Raporti i monitorimit të punës së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut i referohet periudhës nga gushti deri në dhjetor 2023. Ky raport është i ndarë në tre pjesë kryesore që kanë të bëjnë me transparencën, efektivitetin dhe efikasitetin e Këshillit Gjyqësor.

## TRANSPARENCA E KËSHILLIT GJYQËSOR

---



ka zhvilluar  
19 seanca

Në këtë periudhë kohore, KGjRMV-ja zhvilloi **19 seanca**, nga të cilat **3 në dy vazhdime**.

Publikimi i informacioneve në lidhje me konvokimin e seancave kryesisht është bërë në kohë të duhur, por disa herë kishte njoftime për seanca urgjente të cilat për nga përmbajtja e tyre nuk mund të klasifikoheshin si urgjente. Menjëherë pas përfundimit të çdo seance, publikoheshin njoftime lidhur me vendimet dhe konkluzionet e miratuara, por në të njëjtat është përvijuar praktika e mëparshme që konsiston me njoftime shterpe, pa justifikime konkrete, kështu që të njëjtat mund t'i kuptonin vetëm ata që ishin të pranishëm në seancat publike. Kjo praktikë, në periudhën e ardhshme, duhet të tejkalohet me qëllim të përmirësimit të transparencës aktive të KGjRMV-së.

U respektua detyrimi ligjor për publikimin e procesverbaleve të seancave të KGjRMV-së ndërkaq procesverbalet e detajuara janë publikuar pas miratimit të tyre me një vonesë të vogël. Ajo që mund të konstatohet në lidhje me përpilimin e procesverbaleve është se anëtarët kanë reaguar disa herë ndaj mënyrës së përpilimit të tyre nga shërbimi profesional dhe kanë kërkuar që ato gjatë përpilimit të jenë të njëtrajtshëm, përkatësisht të mos ndodhë që në ç'do procesverbal të ketë informacione të njëjta dhe të mos jenë përmbajtësish të ndryshme. Pavarësisht sugjerimeve, ka ende mungesë vullneti tek shërbimi profesional për ta unifikuar përpilimin e procesverbaleve. Nga ana tjetër, disa anëtarë të

KGjRMV-së kanë kërkuar dhe u pranua nga të gjithë, si pjesë e procesverbalit të përfshihet edhe lista e votimit. Kjo kërkohet për transparencë më të madhe të mënyrës së votimit të anëtarëve, por, që nga dhjetori, ky vendim i KGjRMV-së akoma nuk është zbatuar. Ashtu si në periudhën e mëparshme, (janar-korrik 2023) në seancat në të cilat janë miratuar procesverbalet, anëtarët bënin vërejtje për pjesë të caktuara, duke i specifikuar sugjerimet e tyre që i kanë bërë gjatë diskutimeve mbi pikat e rendit të ditës, në drejtim të interpretimit më të detajuar të diskutimeve.

Pas 26 prillit 2023, kur ish-kryetarja e KGjRMV-së, Vesna Dameva u shkarkua në procedurë të paligjshme, u inkorporua praktika që seancat e KGjRMV-së të transmetohen drejtpërdrejtë nga Agjencia Maqedonase e Informimit AMI. Shpesh janë të pranishme edhe media të tjera, si dhe gazetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare që raportojnë lidhur me seancat. Edhe në këtë periudhë kohore vërehet një interesim më i madh sa u përket seancave por edhe sa u përket veprimeve të KGjRMV-së.



## VOTIMI DHE SISTEMI I REGJISTRIMIT AUDIO

---

Gjatë kësaj periudhe raportuese, sistemi elektronik për regjistrimin audio dhe për votim ishte në funksion, kështu që anëtarët votonin përmes sistemit të votimit, që është një mënyrë e rregullt votimi, përveç nëse ndonjëri nga anëtarët dyshon në rezultatin, kështu që ai mund të kërkojë të votohet duke ngritur dorën.



## SEANCAT PUBLIKE TË KGJRMV-SË

---

Sa i përket dinamikës së mbajtjes së seancave, në nivel mujor, nuk ka ndryshime të konsiderueshme krahasuar me raportin paraprak (janar-korrik 2023). Një seancë gjatë muajit ishte gjithmonë e rezervuar për të vendosur mbi parashtesat e qytetarëve dhe personave juridikë, gjë që është edhe detyrim ligjor.

Praktika e mbajtjes së kolegjiut para se të fillojnë seancat vazhdon, megjithatë ka vonesa me fillimin e seancave publike.

Puna e anëtarëve të KGjRMV-së në seanca mund të karakterizohet si mjaft dinamike, me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve në diskutime dhe shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, duke përdorur të drejtën e replikës, argumentimit, arsyetimit, përmes interpretimeve të ndryshme të situatave të caktuara të cilat paraprakisht janë shqyrtuar dhe për të cilat tani më janë miratuar konkluzione ose duke specifikuar disa procedura që nuk janë shpjeguar mjaftueshëm me ligj ose me aktet nënligjore. Por ndonjëherë ka diskutime më intensive, duke lënë përshtypje se anëtarët po bindin njëri-tjetrin, argumenti i kujt është më i ligjshëm, veçanërisht kur anëtarët kanë pikëpamje të ndryshme mbi situatat tani më të shqyrtuara që nuk janë definuar me ligj. Mes tjerash ka edhe mendime të ndara nga anëtarët, të cilat publikohen në faqen e internetit të KGjRMV-së, ndërkaq në seanca gjithnjë e më shpesh deklarohet edhe përgjegjësia individuale e anëtarëve, pavarësisht se bëhet fjalë për një organ kolektiv që vendos me shumicë votash. Diskutimet zgjasin një kohë të gjatë ndërkohë që nuk është respektuar Rregullorja e Punës e KGjRMV-në të cilën është përcaktuar se si dhe sa do të diskutojë çdo anëtar për një çështje të caktuar.



## RAPORTET VJETORE MBI PUNËN E KGJRMV-SË

Raporti vjetor për punën e KGjRMV-së, për vitin 2022, u paraqit në Kuvend brenda afatit të parashikuar me ligj<sup>1</sup> ndërkaq në Seancën Plenare, të mbajtur më datë 11.12.2023, përfundoi leximi i tretë, kështu që ky dokument iu adresua deputetëve për procedimin e mëtejshëm.

### **Prezenca e anëtarëve, sipas funksionit, në seancat e KGjRMV-së**

Ministri i Drejtësisë dhe Kryetari i Gjykatës Supreme të RMV-së (GjSRMV) në Këshillin Gjyqësor janë anëtarë sipas funksionit, por fare nuk marrin pjesë në seanca.

Ministri i Drejtësisë, për shkak të shkarkimit kontrovers dhe të paligjshëm të ish-kryetares Vesna Dameva, u prononcua se nuk do të marrë pjesë në seancat e KGjRMV-së sepse këtë përbërje e konsideron jo legjitime, megjithatë pikëpamjet e tij mbi punën e KGjRMV-së i prezantoi në media përmes kritikave në lidhje me situata të caktuara dhe vendime të miratuara nga Këshilli. Lidhur me kritikën e Ministrit, kryetari por edhe anëtarët, në seancë, ose nëpërmjet njoftimeve, kërkonin nga Ministri të vinte, të fliste me ta, dhe të mos përdorte mediat për të ndikuar mbi KGjRMV.

Për vite me radhë, Ministri i Drejtësisë nuk merr pjesë në seancat, por detyrimi ligjor është akoma aktiv, pavarësisht raporteve të caktuara ndërkombëtare të cilat rekomandojnë që këta funksionarë të mos jenë anëtarë të KGjRMV-së për shkak të ndikimeve të mundshme në punën e Këshillit.

Kryetarja e GjSRMV-së mungesën e saj e arsyetonte me atë se ka shumë angazhime. Fundi i vitit 2023 do të mbetet mend edhe për një situatë tjetër që ka të bëjë me tensionimin e marrëdhënieve ndërmjet kryetares së GjSRMV-së dhe anëtarëve të KGjRMV-së. Kjo rezultoi me paraqitjen e kërkesës për përgjegjësinë e saj. Kjo procedurë u iniciua nga një anëtar i KGjRMV-së në nëntor të vitit 2023, pasi kryetarja 6 muaj nuk u paraqit në seancat e Këshillit. Baza e dytë në kërkesën për iniciimin e procedurës për përgjegjësi të kryetares konsiston me atë se ajo, në një intervistë, bëri një deklaratë rreth ndikimeve politike mbi gjyqtarët e KGjRMV-së, kurse pas intervistës refuzoi të takohej me kryetarin e KGjRMV-së për të diskutuar mbi ndikimet dhe zgjidhjen e situatës. Pas iniciimit të procedurës për përgjegjësi, me kërkesë të kryetares, procedura ishte transparente për publikun, në të njëjtën u prezantuan bazat e përgjegjësisë dhe mbrojtja e kryetares. Në përputhje me kuadrin ligjor, Komisioni që e zbatoi marrjen në pyetje të palëve dhe procedurën e provës, përpilon një raport dhe të njëjtin ia paraqet KGjRMV-së për veprime të mëtejshme. Kjo procedurë përsëri e ndalon publikun, ndërkaq ka pasur reagime jo vetëm nga publiku profesional dhe OJQ-të, por edhe nga komuniteti ndërkombëtar, duke ua bërë me dije të jenë të kujdesshëm gjatë zhvillimit të procedurës, e cila është karakterizuar si e paligjshme.

Sipas legjislacionit, kryetarja e GjSRMV-së nuk ka të drejtë vote në seanca, por prania e saj e nënkupton mundësinë që të diskutojë për çështje të rëndësishme me ç'rast do shkëmbejnë përvoja që kanë të bëjnë me punën e Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatës Supreme, por edhe me gjyqësorit në përgjithësi.

<sup>1</sup> <https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal.nspx?param=39a30df8-b2ac-4133-a706-915071aa5a7c>



## ANALIZË E PËRMBAJTJES SË PUBLIKIMEVE DHE DEKLARATAVE PËR MEDIA TË KËSHILLIT GJYQËSOR

---

Komunikimi i KGjRMV-së me publikun e gjerë mund të vërehet se është më i mirë, si dhe komunikimi me gazetarët dhe mediat në përgjithësi. Gjatë kësaj periudhe, ka pasur më shumë reagime të KGjRMV-së në lidhje me ngjarjet në bazë ditore që kanë të bëjnë me shkarkimin kontrovers të kryetares Vesna Dameva. Mjaft sulme, përmes mediave, mund të vërehen nga Ministri i Drejtësisë, si dhe nga OJQ-të dhe ekspertët juridikë, por të gjitha situatat u adresuan nga KGjRMV-së përmes reagimeve të publikuara në faqen e tyre të internetit.

Nga ana tjetër vazhdoi praktika e publikimit të njoftimeve për takimet dhe eventet në të cilat ka marrë pjesë kryetari ose anëtarët e Këshillit Gjyqësor.



## TRANSPARENCA NDAJ PUBLIKUT DHE MEDIAVE

---

Gjatë periudhës kohore në të cilën është monitoruar puna e KGjRMV-së, ka pasur interesim të vazhdueshëm për punën jo vetëm nga mediat, por edhe nga organizatat joqeveritare dhe publiku i përgjithshme. Për shkak të ngjarjeve gjatë prillit dhe majit, me shkarkimin e paligjshëm të ish-kryetares Vesna Dameva, Ambasadori i BE-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut njoftoi ardhjen e një Misioni Vlerësues. Ky mision ishte i pranishëm në korrik dhe shtator 2023. Pas takimeve me të gjitha palët e interesuara, Misioni Vlerësues paraqiti një raport mbi situatën e konstatuar, i cili përmbante propozim masa dhe aktivitete, të ndara në afatshkurtra dhe afatgjata, me një numër në total prej 40. Në disa prej tyre, është paraparë që KGjRMV-ja t'i realizojë ato vetë, duke theksuar se procedura duhet të ndryshohet në situata të caktuara, ndërsa në disa raste detyrimisht duhet të ndryshohet ligji me qëllim të përmirësimit të disa procedurave, ndërsa në disa prej rekomandimeve kërkohet edhe ndryshimi i Kushtetutës.

# EFEKTIVITETI DHE EFIKASITETI I KËSHILLIT GJYQËSOR

---



## ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT GJYQËSOR NGA RADHËT E GJYQTARËVE

---

Pas konstatimit të dorëheqjeve të dy anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, nga radhët e gjyqtarëve, gjyqtares Mirjana Radevska Stefkova nga Gjykata Supreme, dhe gjyqtarit nga Gjykata e Apelit Shkup - Zoran Gerasimovski, në korrik 2023, u zgjodh vetëm një anëtar nga radhët e gjyqtarëve - gjyqtarja e Gjykatës Themelore Civile Antoaneta Dimovska, si përfaqësuese nga rajoni i apelit Shkup me gjykatat administrative.

Gjatë kësaj periudhe raportuese u publikuan tre shpallje për zgjedhjen e anëtarit të KGjRMV-së nga radhët e gjyqtarëve të GjSRMV-së, por nuk u paraqit asnjë kandidat. Problemi i arsyeve të mundshme për këtë mungesë interesimi të gjyqtarëve për t'u paraqitur si kandidatë u shqyrtua në një seancë të KGjRMV-së. Arsyeja e parë e mundshme për këtë konsiderohet situata aktuale në KGjRMV-së, kështu që gjyqtarët nuk duan të jenë pjesë e këtij autoriteti, që është shprehje e mosbesimit që gjyqtarët dhe qytetarët kanë ndaj këtij institucioni. Arsyeja e dytë konsiston me dispozitën ligjore sipas së cilës neni 6 paragrafi 1 alineja 2 të Ligjit për KGjRMV-së<sup>2</sup> përcakton " - tetë anëtarë të Këshillit i zgjedhin gjyqtarët nga radhët e tyre, me ç'rast tre nga anëtarët e zgjedhur u përkasin bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe me këtë do të respektohet përfaqësimi i drejtë dhe adekuat i qytetarëve që u përkasin të gjitha bashkësive". Çështja e votimit sipas parimit të Badenterit dhe përfaqësimi i drejtë i bashkësive më të vogla etnike është padyshim një përfitim kushtetues, por megjithatë konsiderojmë se në përzgjedhjen dhe avancimin e gjyqtarëve i vetmi kusht vendimtar duhet të jetë cilësia, profesionalizmi dhe integriteti i kandidatëve për gjyqtarë.



## ZGJEDHJA E GJYQTARËVE DHE KRYETARËVE TË GJYKATAVE

---

Në periudhën raportuese u realizua edhe zgjedhja e gjyqtarëve në gjykatat themelore nga kandidatët e mbetur të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publik (AGjPP), megjithatë u realizua edhe zgjedhja e shumëpritur e gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Shkup. Seancat gjatë të cilave u zgjodhën gjyqtarët, përkatësisht u avancuan, ishin me interes të madh për publikun dhe mediat, sepse pas një periudhe të gjatë kohore, gjyqtarët u avancuan në gjykatën më të madhe të apelit në vend konform mënyrës së re të vlerësimit/notimit të gjyqtarëve, të parashikuar me Ligjin për KGjRMV-së, nga viti 2019.

Sa për rikujtim, gjatë muajit korrik 2023, janë zgjedhur 24 gjyqtarë nga radhët e kandidatëve të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë në gjykatat themelore në vend. Më 1 shtator 2023, ata dhanë deklaratë solemne, me ç'rast filluan zyrtarisht ta ushtrijnë funk-

---

<sup>2</sup> Neni 6 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.109/2019



sionin e gjyqtarit në gjykatat në të cilat ata u zgjodhën. Por më 6 shtator 2023, KGjRMV-së mori vendime për transferimin e tyre të përkohshëm për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në një gjykatë tjetër, për një periudhë prej një (1) viti nga data e transferimit. Ky vendim i KGjRMV-së vjen nga nevoja për të mbuluar mungesën e gjyqtarëve në gjykatat në të gjithë vendin, ku, përkrah shpalljeve të publikuara, kandidatët nga AGjPP-ja nuk u paraqitën. Siç deklaruan anëtarët e KGjRMV-së, gjatë zgjedhjes së tyre ata ua bënë me dije gjyqtarëve se ekziston mundësia që edhe ata të referohen, përkatësisht të transferohen në një gjykatë tjetër për të ushtruar funksionin e gjyqtarit, me ç'tast morën pëlqimin me gojë prej tyre. Megjithatë, pas këtij vendimi të KGjRMV-së, disa nga gjyqtarët e transferuar përkohësisht paraqitën ankesa në GjSRMV-së, kështu që organi i shkallës së dytë mori vendim t'i kthejë ato në KGjRMV-së për vendimmarrje të sërishme, sepse arsyet e transferimit të tyre të përkohshëm në një gjykatë tjetër nuk u justifikuan sa duhet në vendimet për transferim. KGjRMV-ja përsëri mori vendim si herën e kaluar, dhe kjo i dha fund këtij procesi të zgjedhjes së gjyqtarëve në gjykatat themelore të gjeneratës së 7-të të kandidatëve të AGjPP-së.

Në seancën e mbajtur më 26 shtator 2023, u zgjodhën tre gjyqtarë të rinj të Gjykatës Themelore Civile Shkup dhe tre gjyqtarë të rinj të Gjykatës Themelore Penale Shkup nga kandidatët e mbetur të gjeneratës së shtatë të AGjPP-së. Këshilli Gjyqësor, pas përfundimit të procedurës së parashikuar me ligj dhe me aktet nënligjore, përcaktoi listën e renditjes së kandidatëve për gjyqtarë për secilën gjykatë individualisht. Kandidatët u listuan sipas pikëve të marra nga AGjPP-ja dhe pikëve në bazë të intervistës së zhvilluar nga anëtarët e Komisionit të KGjRMV-së. Në seancë, anëtarët e Këshillit Gjyqësor theksuan se pikët nga lista e renditjes së kandidatëve të AGjPP-së dhe lista përfundimtare e renditjes së kandidatëve të KGjRMV-së nuk ndryshojnë shumë, që do të thotë se kandidatët e kanë dëshmuar suksesin e tyre para komisionit që e zhvilloi intervistën.

Në seancën e datës 15 nëntor 2023, u zgjodhën katër gjyqtarë të rinj në Gjykatën e Apelit Shkup, nga fusha civile, dhe katër gjyqtarë nga fusha penale.

Në shpalljen për zgjedhjen e gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Shkup, gjithsej u paraqitën 63 kandidatë, nga të cilët 34 për fushën penale dhe 29 për fushën civile. Në seancë, për secilin kandidat individualisht, u prezantuan pikët që i fituan, si nga notimi kualitativ ashtu edhe nga notimi kuantitativ sipas secilit kriter të përcaktuar me ligj. Bazuar në pikët e fituara nga e gjithë procedura e notimit, u përgatit lista e renditjes së kandidatëve sipas së cilës votohej, duke filluar nga kandidati që ishte i pari në listën e renditjes me numër më të lartë të pikëve. Në përputhje me ligjin, gjyqtari i cili do të marrë 8 vota nga anëtarët e KGjRMV-së me të drejtë vote, konsiderohet i zgjedhur. Kur do të votohen një numër i mjaftueshëm kandidatësh sipas shpalljes, ndërpritet votimi i mëtejshëm dhe nuk ofrohet mundësia e votimit të kandidatëve të tjerë dhe të absolvohet lista e renditjes së kandidatëve.

Kjo praktikë ka qenë e pranishme në KGjRMV-së edhe para miratimit të ligjit të ri dhe e njëjta i nënshtrohej kritikave për shkak se kandidatëve të tjerë nga lista e renditjes nuk u është dhënë mundësia për t'u votuar. Gjatë veprimit të këtillë shtrohet pyetja se ndonjë kandidat tjetër nga lista e renditjes a mund të marrë numër të njëjtë madje edhe një numër më të madh votash nga anëtarët e KGjRMV-së.

Zgjedhja e gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Shkup, si nga fusha penale ashtu edhe nga ajo civile, u pasua me shumë kritika dhe komente nga publiku. Kjo për shkak të rrjedhës së përzgjedhjes. Me fjalë të tjera, nga lista e renditjes së kandidatëve e përpiluar në përputhje me të gjithë procedurën e parashikuar për avancimin e gjyqtarëve, kandidatët nuk janë përzgjedhur sipas renditjes, përkatësisht në seancë, para fillimit të votimit, disa nga anëtarët

e KGjRMV-së kanë dhënë një shpjegim të shkurtër se pse nuk do të votonin për disa nga kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Apelit të cilët janë listuar në vendet e para, përkatësisht në vendet më lartë në listën e renditjes të përpiluar nga komisioni. Në këtë mënyrë, ata justifikuan të drejtën e tyre për të mos i zgjedhur kandidatët e renditur në vendet e para të listës për gjyqtarë, por të votojnë sipas bindjes së tyre. Pikërisht kjo mos përzgjedhje e kandidatëve të renditur në vendet e para të listës, përkatësisht përzgjedhja e kandidatëve vijues, rezultoi në kritika dhe dyshime të mëdha në publik se në këtë rast ka presione dhe ndikime politike për zgjedhjen e gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Shkup.

Edhe në raportet e mëparshme të Institutit për të Drejtat e Njeriut (IDNj) kishte vërejtje se anëtarët e KGjRMV-së kanë të drejtë të votojnë për kandidatin që ata besojnë se do ta ushtrojë më mirë funksionin e gjyqtarit në një gjykatë më të lartë. Por nga ana tjetër, thelbi i gjithë procedurës së notimit anashkalohet dhe vihet në pikëpyetje. Së këtejmi, bëhet fjalë për një notim/vlerësim gjithëpërfshirës, në të cilin kandidatët për gjyqtarë vlerësohen sipas treguesve të përcaktuar në mënyrë strikte dhe marrin nota konkrete. Qëllimi i këtij notimi është shmangia e elementit subjektiv të notimit nga anëtarët e KGjRMV-së, sigurimi i zbatimit të plotë të merit-sistemit, si dhe notimin sa i përket cilësisë së punës së gjyqtarëve ta bëjnë kolegët e tyre nga një gjykatë më e lartë dhe në këtë mënyrë të garantohet zgjedhja e pavarur dhe e paanshme e gjyqtarëve në një gjykatë më të lartë.

Në përputhje me ligjin, anëtarët e KGjRMV-së janë të detyruar të japin një arsytim vetëm për kandidatët që i kanë zgjedhur për gjyqtarë, përkatësisht të cilët i kanë avancuar. Arsyetimet e tyre kanë të bëjnë me përsëritjen e pretendimeve të kryetarit të komisionit përgjegjës për sublimimin e notave dhe përpilimin e listës së renditjes së kandidatëve. Në rast se ndonjëri prej anëtarëve e njuh gjyqtarin konkret, meqë ai vjen nga ajo gjykatë ose nga ai juridiksion i apelit, atëherë apostrofohen edhe cilësi të tjera, si integriteti, vlerat morale dhe etike, ndërgjegjja dhe profesionalizmi, por vetëm si floskula të përgjithshme.

Gjatë përzgjedhjes së kandidatit të listuar në vendin e parë, theks i veçantë i përkushtohet pikëve të larta që i ka marrë gjatë notimit. Për anëtarët e KGjRMV-së është tregues për një kandidat cilësor, të dëshmuar në ushtrimin e funksionit të tij. Por kur zgjidhet një kandidat i cili nuk është ndër të listuarit e parë, atëherë specifikohen attribute të tjera që janë theksuar më lartë në tekst, madje theksohet se ndaj atij kandidati nuk janë paraqitur parashtrës nga qytetarët apo personat juridikë.

Nëse një kandidat nuk zgjidhet unanimsisht, gjyqtarët që nuk kanë votuar për të, më së shpeshti distancohen nga komentet ose vetëm prononcohen se konsiderojnë se ai nuk duhet të zgjidhet, pa hyrë në detaje dhe pa dhënë arsye konkrete.

Të pakënaqurit, gjegjësisht kandidatët që nuk janë zgjedhur për gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Shkup, parashtruan ankesa pranë GjSRMV-së, të cilat u refuzuan si të pabaza. Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut konstaton se Këshilli Gjyqësor zhvilloi procedurë të ligjshme për zgjedhjen e gjyqtarëve në një gjykatë më të lartë, se veproi në përputhje me autorizimet që rezultojnë nga dispozitat e Ligjit për Gjykatat dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor, si dhe konform akteve nënligjore në fuqi, dhe e justifikoi vendimin e tij për zgjedhjen e gjyqtarëve.<sup>3</sup>

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Këshilli Gjyqësor zgjodhi 10 kryetarë të rinj të gjykatave në Gjykatën Themelore të Kumanovës, Gjykatën Themelore të Negotinës, Gjykatën Themelore të Kërçovës, Gjykatën Themelore të Kriva Pallankës, Gjykatën Themelore Civile Shkup, Gjykatën e Apelit Shkup, Gjykatën e Apelit Shtip, Gjykatën Themelore të Prilepit,

3 Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. YCCЖИ-1/23

Gjykatën Themelore të Manastirit dhe Gjykatën Themelore të Shtipit. U zgjodhën edhe UD kryetari i Gjykatës Themelore të Krushevës, Gjykatës së Lartë Administrative, Gjykatës Themelore të Velesit, Gjykatës Themelore të Dellçevës, Gjykatës Themelore të Strugës dhe Gjykatës Themelore të Kavadarit, ndërkaq për shkak të mungesës së kandidatëve të paraqitur në shpalljet për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës në Krushevë dhe Gjykatës së Lartë Administrative, nuk u bë zgjedhja, ndërsa procedura për Gjykatën Themelore të Velesit është në rrjedhë e sipër.

Për të përcaktuar në detaje numrin e nevojshëm të vendeve gjyqësore nëpër gjykata, ndërkaq në bazë të një numri më të madh parametrash, KGjRMV-ja hartoi një analizë të vendeve të nevojshme të gjyqtarëve në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykatën e Lartë Administrative, Gjykatën e Apelit Shkup, Gjykatën e Apelit Manastir, Gjykatën e Apelit Gostivar dhe Gjykatën e Apelit Shtip, dhe mbi këtë bazë janë miratuar vendime për publikimin e shpalljeve për zgjedhjen e gjyqtarëve në **Gjykatën Supreme të RMV-së** – 6 gjyqtarë, nga të cilët 3 për çështje civile dhe 3 për çështje penale; në **Gjykatën e Apelit Shkup** – 10 gjyqtarë, nga të cilët 6 për çështje civile dhe 4 për çështje penale; në **Gjykatën e Apelit Manastir** – 4 gjyqtarë, nga të cilët 3 për çështje civile dhe 1 për çështje penale; në **Gjykatën e Apelit Gostivar** – dy gjyqtarë për çështje civile; dhe në Gjykatën e Apelit Shtip 1 gjyqtar për çështje civile.



## SHKARKIMI I GJYQTARËVE DHE KRYETARËVE TË GJYKATAVE

Në periudhën kohore deri në dhjetor 2023, Këshilli Gjyqësor konstatoi ndërprerje të funksionit të gjyqtarit për shkak të pensionit të pleqërisë të 15 gjyqtarëve, , me ç'rast vazhdon tendenca e mungesës së gjyqtarëve në gjykatat themelore dhe ato të apelit. Ky problem i madh që u shfaq në gjyqësor është diskutuar disa herë në seancat e KGjRMV-së, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje për bajpasimin e mungesës së gjyqtarëve në të gjitha gjykatat e vendit, por, përveç plotësimit të vendeve vakante nëpërmjet përzgjedhjes së kandidatëve nga AGjPP-ja dhe përmes referimit nga një gjykatë në tjetrën, aktualisht nuk ka asnjë mënyrë tjetër për ta zgjidhur këtë problem, ndërkaq ai ndikon jo vetëm në përditësimin e gjykatave, por edhe në sigurimin e aksesit në drejtësi për qytetarët.

Gjatë vitit 2023, KGjRMV-ja mori disa vendime me të cilat shqiptoi masa disiplinore në bazë të kërkesave për ngritje të procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarëve ose kryetarit të gjykatës. Së këtijmi, në vitin 2023, një (1) gjyqtar nga Gjykata Themelore V u shkarkua në mënyrë të plotfuqishme , u shqiptuan pesë(5) masa disiplinore për uljen e pagës së gjyqtarëve në Gjykatën Themelore G, Gjykatën Themelore O., Gjykatën e Apelit Sh dhe Gjykatën e Apelit Sh. Dy (2) masa disiplinore vërejtje me shkrim iu shqiptuan një gjyqtari të GjSRMV-së dhe një gjyqtari të Gjykatës Themelore G, ndërkaq për një (1) gjyqtar të GjSRMV-së procedura për përcaktimin e përgjegjësisë u ndërpre.



## MONITORIMI I PUNËS SË GJYKATAVE

---

Monitorimin e punës së gjykatave KGjRMV-ja e realizon përmes shqyrtimit dhe vlerësimit të raporteve tremujore dhe vjetore, por edhe përmes vizitave në gjykata nga komisionet e përbëra nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor, siç parashikohet në Planin Intern për Monitorimin dhe Vlerësimin e Punës së Gjykatave, Gjyqtarëve dhe Kryetarëve të Gjykatave për vitin 2023.

Nga raportet tremujore mbi punën e gjykatave mund të konstatohet se vazhdon tendenca e gjykatave të pa përditësuara, ndërkaq si shkak për gjendjen e këtillë specifikohet numri i reduktuar i gjyqtarëve, numri i pamjaftueshëm i administratës gjyqësore si dhe rritja e numrit të çështjeve përkatësisht lëndëve.

Është praktikë e zakonshme, pas vizitave nëpër gjykata, anëtarët e komisionit që e kanë realizuar vizitën, në seancë ta prezantojnë raportin e vizitës duke i theksuar gjetjet më domethënëse që i kanë konstatuar, si dhe duke propozuar konkluzione për veprime të mëtejshme, nëse janë konstatuar mangësi në punën e gjykatave apo të disa gjyqtarëve apo kryetarëve të gjykatave. Nëse paraqitet nevoja për një vizitë të jashtëzakonshme në ndonjë gjykatë, ndërkaq arsyet për këtë janë lëndët gjyqësore me interes për publikun ose parashtrësasat e qytetarëve ose personave juridikë për situata të caktuara joadekuata në gjykatë, në ato raste miratohet një konkluzion i veçantë, artikulohe arsyet e vizitës së jashtëzakonshme në një gjykatë konkrete. Kështu, gjatë kësaj periudhe raportuese, u realizuan disa vizita të gjykatave, kurse në seancë u prezantuan dhe miratuan raportet nga vizitat e punës të Gjykatës së Apelit Shtip, Gjykatës Administrative Shkup, Gjykatës së Apelit Shkup, Gjykatës Themelore Kumanovë, Gjykatës Themelore Strumicë; Gjykatës së Apelit Gostivar, Gjykatës Themelore Koçani, Gjykatës Themelore Kratovë, si dhe raportet nga vizitat e punës së Gjykatës Themelore Civile Shkup, Gjykatës Themelore Penale Shkup, Gjykatës së Apelit Shkup dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Siç parashikohet me ligj, dhe në përputhje me praktikën e deritanishme të KGjRMV-së, kah fundi i vitit 2023, u shqyrtua dhe u miratua Plani Intern për Monitorimin dhe Vlerësimin e Punës së Gjykatave, Gjyqtarëve dhe Kryetarëve të Gjykatave për vitin 2024, si dhe Programi i Punës së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024.



## VENDIMARRJA LIDHUR ME PARASHTRËSAT E QYTETARËVE DHE PERSONAVE JURIDIKË

---

Parashtrësasat e qytetarëve dhe personave juridikë, të cilat paraqiten në KGjRMV, që kanë të bëjnë me punën e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, shqyrtohen dhe zgjidhen rregullisht duke respektuar afatet ligjore.

Në gjysmën e dytë të vitit 2023 janë shqyrtuar rreth 180 parashtrësasat të paraqitura nga qytetarë dhe persona juridikë.

Këshilli Gjyqësor pjesën më të madhe të parashtrësasave i refuzon si të pabazuara, duke e marrë para sysh se me parashtrësasat qytetarët apo personat juridikë kërkojnë modifikimin


e vendimit gjyqësor, pasi që nuk janë të kënaqur me të njëjtin. Në shumicën e rasteve, Këshilli Gjyqësor gjen se procedura e lëndës mund të bëhet edhe sipas ankesës në gjykatën e shkallës së dytë, kështu që pretendimet e parashtresës gjykata e shkallës së dytë do t'i vlerësojë si pretendime ankimore gjatë vendimmarrjes, dhe meqë Këshilli Gjyqësor nuk ka ingerenca të ndërhyjë në vendimet gjyqësore, as t'i ndryshojë ato, nuk gjen bazë për të vepruar në lidhje me parashtresat e paraqitura.

Nga ana tjetër mund të vërehet edhe hedhja poshtë e parashtresave, ndërsa si arsye kryesore për hedhjen poshtë theksohet mungesa e fakteve të reja në lidhje me parashtresën e paraqitur, pastaj fakti që parashtresa tashmë është shqyrtuar në një nga seancat e mëparshme ose për shkak se nuk i përmban të gjitha të dhënat që janë të nevojshme për t'u shqyrtuar.

Në këtë periudhë pati edhe një numër në rritje të parashtresave të bazuara, gjë që është për tu përshëndetur. Kjo do të thotë se parashtresat përmbajnë më shumë prova nga të cilat anëtarët e KGjRMV-së gjatë shqyrtimit mund të përcaktojnë indikacione të punës së pandërgjegjshme ose joprofesionale të një gjyqtari. Me rëndësi për këto parashtresa është se, kur bëhet fjalë për një parashtresë në të cilën gjyqtari i ka tejkualuar afatet për të vepruar, ose për publikimin e vendimit, apo për hartimin e vendimit, anëtarët e KGjRMV-së e konstatojnë këtë. Një nga arsyet e veprimit të këtillë konsiston me atë se ky qëndrim bën pjesë në kriteret e vlerësimit të gjyqtarëve, në përputhje me Metodologjinë e vlerësimit të tyre. Rrjedhimisht me këtë, në rastet kur bazat e paraqitura në parashtresat nuk janë të mjaftueshme për ngritjen e procedurës për përgjegjësi të gjyqtarit në fjalë, parashtresat e bazuara do të jenë pjesë e notës së gjyqtarit.

# KONKLUZIONE

---



Në periudhën kohore nga gushti deri në dhjetor 2023, Këshilli Gjyqësor kaloi nëpër presione të mëdha nga publiku, ekspertët vendas dhe organizatat joqeveritare, mediat dhe institucionet ndërkombëtare për shkak të procedurës së paligjshme të shkarkimit të ish-kryetares së Këshillit Gjyqësor Vesna Dameva, por disa mospërputhje u vunë re edhe në pjesën tjetër të punës në kuadër të kompetencës së Këshillit Gjyqësor, ndërkaq e gjithë kjo ndikoi edhe mbi parametrat e monitorimit të punës së tij.



Puna në kolegji me në të cilat merren vendime të cilat konvokohen para fillimit të seancës, konvokimi i seancave emergjente të cilat për nga përmbajtja nuk kanë asgjë urgjente - e gjithë kjo është pjesë e praktikave që ndikuan negativisht mbi transparencën e punës së Këshillit Gjyqësor dhe reputacionin e tij në publik.




Këshilli Gjyqësor rregullisht e ka ushtruar punën e tij në lidhje me trajtimin e parashtrësve, zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat themelore, vizitat e punës në gjykata, vlerësimin/notimin e rregullt të gjyqtarëve, si dhe kontrollin mbi funksionimin e gjykatave përmes vizitave dhe raporteve tremujore.



Disa tema mbeten të hapura për sa i përket efektivitetit dhe efikasitetit, por edhe sa i përket reputacionit dhe besimit midis gjyqtarëve dhe publikut, si dhe sa i përket veprimit jo konsistent të anëtarëve të KGjRMV-së gjatë zbatimit konsekuent dhe në të gjitha rastet e kushteve në lidhje me dokumentet e listuara në mënyrë taksative të nevojshme për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave.



Aspekti pozitiv konsiston me përcaktimin e një numri më të madh të parashtrësve nga qytetarët si të bazuara, pasi Këshilli Gjyqësor mund t'i marrë ato në konsideratë gjatë përcaktimit të indikacioneve të punës së pandërgjegjshme dhe joprofesionale të një gjyqtari.



Gjatë përzgjedhjes së gjyqtarëve në një gjykatë më të lartë, nga lista e renditjes së kandidatëve e përpiluar në përputhje me procedurën e parashikuar për avancimin e gjyqtarëve, nuk zgjidhen gjyqtarët e listuar në vendet e para, por gjyqtarët e listuar në vijim, ndërkaq për këtë çështje nuk është dhënë asnjë justifikim konkret pse ata gjyqtarë nuk meritojnë të avancohen. Edhe pse kjo mundësi është përfshirë në Ligjin për KGjRMV-së, pikërisht për shkak të kritikave, nevojitet të zbatohet një procedurë integrale e vlerësimit në mënyrë që të respektohet merit-sistemi. Kjo e rrënon besimin e gjyqtarëve sa i përket pavarësisë së KGjRMV-së, i dekurajon gjyqtarët në synimin për të arritur nota të shkëlqyeshme dhe të paraqiten në shpallje, ndërkaq gjykatat i detyron të gjykojnë me një numër të reduktuar gjyqtarësh. E gjithë kjo ndikon mbi efikasitetin dhe efektivitetin e punës së gjykatave dhe rezulton me një qasje joadekuate në drejtësi për qytetarët.



Si çështje e hapur edhe më tutje mbetet aktuale, gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve, ndërprerja e votimit të mëtejshëm pas përzgjedhjes së një numri të mjaftueshëm kandidatësh sipas shpalljes, me ç'rast kandidatëve të tjerë në listën e renditjes nuk u jepet mundësia të votohen dhe të marrin numër të njëjtë ose një numër më të madh votash. Mungesa e kandidatëve në shpalljet për gjykatat më të vogla,

gjë e cila përsëritet tani më një kohë të gjatë, ndikon në punën e këtyre gjykatave dhe është një çështje që duhet të merret në konsideratë gjatë miratimit të dokumenteve strategjike dhe ndryshimeve ligjore.



Besimi në Këshillin Gjyqësor, i cili është në një nivel relativisht të ulët, duhet të rritet edhe në mesin e vetë gjyqtarëve, ndërkaj një tregues për këtë është interesimi i ulët i gjyqtarëve të kandidohen për anëtarë të Këshillit Gjyqësor.



Kjo situatë e vë në pikëpyetje jo vetëm transparencën, efektivitetin dhe efikasitetin në punën e Këshillit Gjyqësor, por edhe reputacionin e Këshillit Gjyqësor si institucion, si dhe ushtrimin e kompetencave të rregullta, kujdesin për reputacionin e gjyqtarëve dhe besimin e qytetarëve ndaj gjyqësorit.



# REKOMANDIME

---

Në bazë të monitorimit të seancave të hapura të Këshillit Gjyqësor, raporteve të Këshillit Gjyqësor, publikimeve dhe dokumenteve të publikuara në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe publikimeve në media, mund të propozohen rekomandimet si vijon:



Nevojiten ndryshime të legjislacionit në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të Misionit Vlerësues të Delegacionit të BE-së në RMV.



Në periudhën e ardhshme, Këshilli Gjyqësor duhet të përqendrojë kapacitetet e tij në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj gjyqësorit përmes një roli pro aktiv dhe ndërmarrjes së masave për reduktimin e perceptimit për ekzistimin e korrupsionit në gjyqësor, duke e rritur bashkëpunimin me të gjitha institucionet që punojnë në këtë fushë dhe duke iu drejtuar më shpesh opinionit publik.



Këshilli Gjyqësor në mënyrë konsekuente duhet t'i zbatojë rezultatet e vlerësimit/notimit dhe listës së renditjes së kandidatëve gjatë përzgjedhjes së gjyqtarëve në gjykatat më të larta dhe të ofrojë justifikime konkrete pse një gjyqtar nuk duhet të zgjidhet në një gjykatë më të lartë.



Këshilli Gjyqësor duhet të punojë në rritjen e besimit të gjyqtarëve përmes zbatimit konsekuent të dispozitave ligjore.



